



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 923 Prot.

Tiranë, më 24.06 2019

VENDIM Nr. 166, datë 25.06.2019

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"**, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rezidencë vilash 3kat me 1 kat parkim nëntokë" në zonën e Berdeneshit, Bashkia Sarandë Qarku Vlorë**-subjekti "ANSI 2016" sh.p.k., realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Ols Lafe.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rezidencë vilash 3kat me 1 kat parkim nëntokë" në zonën e Berdeneshit, Bashkia Sarandë Qarku Vlorë**-subjekti "ANSI 2016" sh.p.k., realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Ols Lafe.
2. Bazuar në nenin 146, pika 1, të ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", "Personat, të cilët gjatë punimeve bujqësore apo ndonjë fakti çfarëdo ndeshin gjetje rastësore, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji, kanë detyrimin të deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore". Gjithashtu ata duhet të kryejnë procedurën e plotë të cituar në këtë nen, pasi në të kundërt sipas pikës 6 të këtij neni "Mosraportimi në organet kompetente, në kundërshtim me këtë nen, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al